

Çfarë është Instrumenti i Zhvillimit të Viteve të Ciklit të Lartë Fillor (Middle Years Development Instrument - MDI)?

Është një pyetësor me karakter vetë-raportues i MDI që plotësohet nga fëmijët dhe të rinjtë e klasave të 4-ta deri te të 12-ta. Pyetësori me anë të pyetjeve kërkon të zbulojë se si mendojnë dhe ndjehen ata për përvojat e tyre si brenda ashtu edhe jashtë shkollës. Ai përfshin pyetje në lidhje me pesë fushat e zhvillimit që janë të lidhura fort me mirëqenien, shëndetin dhe arritjet shkollore. Këtu jepen përshkrime të shkurtra të çdo domeni dhe 2 pyetje shembull që japin një ide për llojin e pyetjes që po bëhet:



Shëndeti fizik dhe Mirëqenia

Fëmijët bëjnë vlerësimin e mirëqenies së tyre fizike në fushat e shëndetit të përgjithshëm duke përfshirë mirëqenien emocionale, aktivitetin fizik, të ushqyerit dhe zakonet e gjumit. Pyetjet në lidhje me shëndetin fizik dhe mirëqenien përfshijnë:

Në përgjithësi, si do ta përshkruanit shëndetin tuaj?

- a. I dobët (jo mirë)
- b. I pranueshëm
- c. I mirë
- d. I shkëlqyer

Sa shpesh bëni gjumë të mirë gjatë natës?

- a. Asnjëherë
- b. Një herë në javë
- c. 2 herë në javë
- d. 3 herë në javë
- e. 4 herë në javë
- f. 5 herë në javë
- g. 6 herë në javë
- h. Çdo ditë



Koncepti i afërsisë

Fëmijët pyeten për përvojat e tyre të mbështetjes dhe afërsisë me të rritur në shkollat dhe lagjet e tyre, me prindërit ose kujdestarët e tyre në shtëpi, dhe me bashkëmoshatarët. Nxënësve do t'u kërkohet t'u përgjigjen deklaratave të tilla si:

Në shkollën time ka një mësues apo një të rritur tjetër që vërtet kujdeset për mua.

- a. Aspak e vërtetë
- b. Pak e vërtetë
- c. Pak a shumë e vërtetë
- d. Shumë e vërtetë

Në shtëpinë time, ka një prind apo të rritur tjetër që më dëgjon kur unë kam diçka për të thënë.

- a. Aspak e vërtetë
- b. Pak e vërtetë
- c. Pak a shumë e vërtetë
- d. Shumë e vërtetë



Zhvillimi Emocional dhe Social

Fëmijët u përgjigjen pyetjeve rreth mënyrës së tyre aktuale të funksionimit emocional dhe social në 7 fusha: optimizmi, vetë-vlerësimi, lumturia, ndjeshmëria, sjellja prosociale, trishtimi dhe shqetësimet. Nxënësve do t'u kërkohet t'u përgjigjen deklaratave të tilla si:

Kur unë shoh dikë që sillet keq kjo gjë më shqetëson mua.

- a. Nuk pajtohem fare
- b. Nuk pajtohem deri diku
- c. Nuk jam as kundër dhe as pro
- d. Pajtohem deri diku
- e. Pajtohem plotësisht

Jam i lumtur me jetën time.

- a. Nuk pajtohem fare
- b. Nuk pajtohem deri diku
- c. Nuk jam as kundër dhe as pro
- d. Pajtohem deri diku
- e. Pajtohem plotësisht



Përvojat shkollore

Fëmijët pyeten për përvojat e tyre shkollore në 4 fusha: vetë-koncepti akademik, atmosfera shkollore, përkatësia në shkollë dhe përvojat me viktimizimin e bashkëmoshatarëve (bullizmi). Nxënësve do t'u kërkohet t'u përgjigjen deklaratave dhe pyetjeve të tilla si:

Jam i sigurt se unë mund të mësoj aftësitë e marra në mësim në shkollë këtë vit.

- Nuk pajtohem fare
- Nuk pajtohem deri diku
- Nuk jam as kundër dhe as pro
- Pajtohem deri diku
- Pajtohem plotësisht

Ndjej se jam pjesë e kësaj shkolle.

- Nuk pajtohem fare
- Nuk pajtohem deri diku
- Nuk jam as kundër dhe as pro
- Pajtohem deri diku
- Pajtohem plotësisht



Shfrytëzimi i kohës pas orarit shkollor

Fëmijët pyeten në lidhje me kohën që ata kalojnë të angazhuar në organizimin e aktiviteteve të tilla si sporte, muzikë dhe art, si dhe për kohën që ata kalojnë duke parë televizor, kohën që u merr bërja e detyrave të shtëpisë dhe argëtimi me video-lojëra. Nxënësve do t'u kërkohet t'u përgjigjen pyetjeve dhe deklaratave të tilla si:

Gjatë javës së fundit, nga mbarimi i orarit shkollor deri në darkë (rreth orës 3 pasdite deri në 6 pasdite), sa kohë keni shpenzuar duke bërë stërvitje apo sporte për argëtim (për shembull, duke luajtur jashtë, duke ecur me biçikletë, duke bërë patinazh, udhëtim me slitë, lojë me rrathë, not, joga, vallëzim, apo diçka tjetër)?

- Nuk jam marrë me këtë aktivitet
- Më pak se 30 minuta
- 30 minuta deri në 1 orë
- 1-2 orë

- e. 2 orë ose më shumë

Mendoni se çfarë dëshironi të bëni në DITË SHKOLLE nga mbarimi i orarit shkollor deri në darkë (rreth orës 3 pasdite deri në 6 pasdite).

- a. Unë po bëj tashmë aktivitetin që dëshiroj
- b. Do të kisha dëshira të bëja edhe aktivitete të tjera